

UDHËZIM
Nr.1, datë 22.2.2005

PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR.3, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MBIKËQYRJEN DHE KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË
NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 dhe 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në ndarjen II “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të udhëzimit nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 7 shtohen pikat, si më poshtë vijon:

“8. Periudha e garancisë për punimet e ndërtim-montimit në objektet, publike dhe jopublike, të përfunduara, fillon nga data e aktit të kolaudimit të punimeve dhe zgjat nga një deri në dy vjet, gjë që përcaktohet në kontratë, për veprën në tërësi a për pjesë apo procese të veçanta, në varësi të llojit të objektit, kompleksitetit dhe shkallës së vështirësisë së punimeve të kryera.

9. Investitori ose personi i autorizuar prej tij njofton zyrtarisht zbatuesin e punimeve për çdo difekt të ndodhur në veprën gjatë periudhës së garancisë. Zbatuesi është i detyruar ta ndreqë difektin brenda periudhës së garancisë dhe sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për difektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano